



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Ekstrakt

Nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me qytetarët e fshatit Pollatë dhe fshatrave për rreth, mbajtur më dt.17.06.2020.

Takimi filloi në orën 15:30, dhe u mbajt në SHFMU “Shefki Latifi”, në fshatin “Pollatë”. Takimin e hapi dhe e kryesoi z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i shoqëruar nga Donikë Sfishta drejtoreshë Drejtoria e Kulturës Rinis dhe Sportit, Vezir Januzi drejtor Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural. Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë evidentuar dhe nënshkruar në listën për pjesëmarrje e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Tema: Dëgjim Buxhetor rreth përgatitjes së propozim Buxhetit të Komunës për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021/23.

Isuf Latifi, drejtor i DBF e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje që e vlerësoi mjaft të rëndësishme për lokalitetet e kësaj ane, ndër të tjera theksoi.

Për çdo vit gjatë këtyre muajve Komuna zhvillon procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm dhe prioritetet për dy vitet në vijim e që afati i miratimit është fundi i muajit shtator, buxhet i cili është përcaktuar fillimisht mbi bazën e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021/23 dhe Qarkores Buxhetore 2021/23 të Ministrisë së Financave, ftoj qytetarët që të propozojnë dhe të diskutojnë për projektet që kanë nevojë të realizohen.

Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje ndër të tjera theksoi, kërkojmë nga ju që orientim të punës ta keni bujqësinë si mundësi për sigurimin e produkteve dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Prezantimi i programit të subvencioneve për këtë vit nga Drejtoria për Bujqësisë do të ndahet buxhet për ndërtimin edhe të një pende në fshatin “Pollatë”, që është kërkesë e banorëve të fshatit.

Donika Sfishta, drejtoreshë Drejtoria e Kulturës Rinis dhe Sportit, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje ndër të tjera theksoi, ne si Drejtori e Kulturës Rinisë dhe Sportit do ti përgjigjemi kërkesave të këtij lokaliteti që kanë bëjnë me fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Sabri Dema, nga fshati “Pollatë” fillimisht shprehi falënderime sa i përket investimeve në fshatin “Pollatë” e në veçanti për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit dhe paraqiti kërkesat;

-Ndërtimin e pendës për ujitje te mulliri.

-Ndërtimin e pendës për ujitje te shkolla e fshatit.

-Ndërtimin e rrethojave të shkollës.

-Rregullimin e fushës së sportit të SHMFU “Shefki Latifi”, “Pollatë”.

Xhemajl Hoxha nga fshati “Pollatë” theksoi, projektet e cekura nga drejtori i shkollës janë kërkesa të fshatit.

Besim Uka nga fshati “Repë”, shpreh shqetësime për vonesat e ndërtimit të pendës në fshatin Repë, si dhe për shkak të rrjedhës së ujit nga penda nuk po na u mundësohet kyçja në pronat andaj kërkoi gypa për futjen e rrjedhës së pendës në gjatësi 30 metër.

Isuf Latifi drejtor DBF, jep sqarime do të evidentojmë kërkesat e juaja dhe varësisht natyrës së tyre do t'ju përcjellim drejtorive përkatëse.

Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, jep sqarime në bazë të kërkesave tuaja ne do mundohemi që të zgjedhim problemet e juaja dhe të gjithë bujqve dhe fermerëve në të gjitha projektet kapitale që të kemi një bujqësi të zhvilluar andaj për çdo shqetësim dhe kërkesë mos hezitoni kërkesat adresoni te ne dyert janë të hapura dhe brenda kapaciteteve dhe mundësive tona ne do ta bëjmë zgjidhjen e problemeve.

Nexhip Hoxha, nga fshati "Pollatë" shpreh shqetësim për mungesë së ujit për pije dhe për ujitje.

Isuf Latifi drejtor DBF, i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në takim, theksoi ne i morëm të gjitha kërkesat e juaja dhe për disa veç se u dhanë sqarime, natyrisht që të gjitha do t'i analizojmë dhe do t'i vlerësojmë me qëllim të përfshirjes së tyre në planifikimet tre vjeçare buxhetore të Komunës, andaj me kaq e konstatoi të mbyllur këtë takim.

Takimi përfundoi në orën 16:30.

Procesverbalin e mbajti:

Osman Bajrami

Nr.prot. 04-400/01-0030183/20

Podujevë
17.06.2020

Drejtori i DBF
Isuf Latifi